



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8119

Tirane, date 15.12/2015

Drejtuar: Z.LUK RROKU
SHOQERIA "BESJONA IMPEX" SHPK
LAGJIA "BESELIDHJA", PALLATI 132 ,

LEZHE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.555/1 date 05.11.2012.

I nderuar z. Rroku,

Shoqëria "Besjona Impex" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.555/1 date 05.11.2012, për gurë gëlqeror ne objektin "Sake", Shëngjin, Lezhe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.5568/1 date 08.07.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.282/2 date 09.07.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.555/1 date 05.11.2012, për gurë gëlqeror ne objektin "Sake", Shëngjin, Lezhe, për arsye se është punuar duke përdorur praktika te dëmshme te shfrytëzimit te mineraleve. Ky veprim vërehet edhe ne kontrollin e bere ne objekt, nga Reparti i Inspektim te Shpëtimit te Minierave, siç shkruhet ne informacionin e hartuar mbi këtë kontroll, (nr. 533 date 27.04.2015 protokoll i RISHM-it), ku është konstatuar se subjekti ushtron veprimtari minerare i pa pajisur me autorizimin "Për përdorim civil te lendeve plasëse", kështu është lenë detyra për ndërprerjen e menjëhershme te punës me lende plasëse deri ne pajisjen e subjektit me autorizimin përkatës.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim, por edhe lenia e detyrës për te ndërprere punën nga Reparti i Inspektim te Shpëtimit te Minierave, është i mbështetur ne germën "dh" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes**

minerare te shfrytëzimit nr.555/1 date 05.11.2012, për gurë gëlqeror ne objektin “Sake”, Shëngjin, Lezhe, qe shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.555/1 date 05.11.2012, për gurë gëlqeror ne objektin “Sake”, Shëngjin, Lezhe.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

